



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 356/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Hasan Shala Kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Smajl Latifaj kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Rahovec, paraqitur kundër Beqir Mustafes Kryesues i vendvotimit nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Rahovec, për shkak të mungesave të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 16.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pas afatshme ankesa e Smajl Latifaj kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 13.06.2014, nga Smajl Latifaj kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik AAK me numër 28, ku pretendon se në vendvotimin nr. 1601A/01R me datën 08.06.2014, gjatë numërimit të votave, kryesuesi Beqir Mustafa nga PDK, nuk ja ka shënuar votat e fituara në atë vendvotim në procesverbal . Pretenduesi i ankese thotë se informatë e bazoj në formularin e nxjerrë nga vëzhguesit e AAK-së, dhe kërkon që të verifikohen numërimi i votave në këtë vendvotim.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi emrin e një vëzhguesi të AAK-së, dhe deklaratën e tij si dhe Formularin e rezultateve për Kuvendin e Republikës së Kosovës, po të atij vëzhguesit.

PZAP-i, shqyrtoi afatshmerinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pas afatshme

PZAP-i, nga shkresat e lëndës konstatoi se ankesa është e pas afatshme sepse afati ligjor për të parashtruar ankesë në PZAP, për të gjitha parregullsitë që lidhen me ditën e votimit është definuar me nenin 119.1 të LZP-së, në të cilin parashihet se: *“Personi që ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelje ligjore për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit”*. Ndërsa pala ankuese ankesën e ka parashtruar në PZAP, me datë 13.06.2014 në ora 14:42 nga kjo del se ankesa në fjalë është parashtruar pas afatit të përcaktuar sipas dispozitës së sipërsënuar, andaj duke u bazuar nenin 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 356/2014 më datën 16.06.2014

Kryesuesi i Panelit

Hasan Shala



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.